REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:252234
Datë: 07.02.2023
Numri i dokumentit: 03946899

C.nr.1554/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, **Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtarja Kaltrinë Haliti, në çështjen kontestimore të paditësve N.B nga ..., N.H nga fshati Llashticë, Komuna e Gjilani, S.A nga ... S.SH nga fshati ..., Komuna e Gjilani dhe SH.SH nga Gjilani, të cilët i përfaqëson me autorizim M.H, avokate nga Vitia, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj me autorizim Burim Maliqi nga Gjilani, me objekt kontesti kompensimi i diferencën në pagë për shkak të gradimit-licencimit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, me datë 11.01.2023 mori këtë:

AKTGJYKIM

I. REFUZOHEN në tërësi si të pabazuara kërkesëpaditë e paditësve edhe atë**:** N.B nga Gjilani, N.H nga fshati Llashticë dhe S.SH nga fshati Llashticë, e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditësve në emër të diferencës në pagë, për punonjësin me licencim/fakultet, për periudhën kohore nga muaji Maj 2017 deri në muajin janar 2021, për 45 muaj t'ia paguaj shumën prej 2, 490.75 €, duke llogaritur shumën prej 55.35 € në muaj, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. S.A Poroshtica, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditëses në emër të diferencës në pagë, për punonjësin me licencim/master, për periudhën kohore nga muaji maj 2017 deri në muajin janar 2021, për 45 muaj t'ia paguaj shumën prej 4, 0046.35 €, duke llogaritur shumën prej 89.03 € në muaj, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm dhe SH.SH, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit në emër të diferencës në pagë, për punonjësin me licencim dhe kualifikim shkollor SHLP, për periudhën kohore nga muaji maj 2017 deri në muajin janar 2021, për 45 muaj t'ia paguaj shumën prej 2, 490.75 €, duke llogaritur shumën prej 38.95 € në muaj, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

2021:252235

Fillimisht, paditësit përmes të autorizuarës së saj, avokates M.H nga Vitia , në këtë gjykatë me datë 08.11.2021 ka paraqitur padi kundër të padituerës Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, për kompensimin e diferencës në pagë për punonjësin me licencim konform Kontratës Kolektive. Mirëpo me parashtresën e datës 11.01.2023 si dhe në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur në po të njëjtën datë e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që nga gjykata ka kërkuar që për paditësit N.B nga Gjilani, N.H nga fshati Llashticë dhe S.SH nga fshati Llashticë, të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që në emër të diferencës në pagë, për punonjësin me licencim/fakultet, për periudhën kohore nga muaji Maj 2017 deri në muajin janar 2021, për 45 muaj t'ia paguaj shumën prej nga 2, 490.75 €, duke llogaritur shumën prej 55.35 € në muaj, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, secilit prej tyre. Ndërsa për paditësen S.A Poroshtica, ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditëses në emër të diferencës në pagë, për punonjësin me licencim/master, për periudhën kohore nga muaji maj 2017 deri në muajin janar 2021, për 45 muaj t'ia paguaj shumën prej 4, 0046.35 €, duke llogaritur shumën prej 89.03 € në muaj, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Kurse për paditësin SH.SH, ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit në emër të diferencës në pagë, për punonjësin me licencim dhe kualifikim shkollor SHLP, për periudhën kohore nga muaji maj 2017 deri në muajin janar 2021, për 45 muaj t'ia paguaj shumën prej 2, 490.75 €, duke llogaritur shumën prej 38.95 € në muaj, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Gjithashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe atë 624 € për përpilim të padisë, 21€ për taksë gjyqësore për padi, 811.20 € për një seancë të mbajtur, si dhe për parashtresën për precizim të kërkesëpadisë 624 €.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas pranimit të padisë duke vepruar konform nenit 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar aktvendimin për përgjegjje në padi. Me të cilin e ka njoftuar të padituërën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dorëzuar në këtë gjykatë me datë 09.12.2021, ka kërkuar që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve. Si në përgjigje në padi, ashtu edhe në seancë përgatitore dhe atë të shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve me arsyetimin se paditësve nuk i takon kurfar diference në pagë sepse janë duke u paguar konform koeficientit të paraparë me konkurs për pozitën që kanë krijuar marrëdhënie pune dhe se me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës në konkurset e publikuara nga DKA askund nuk ceket se i punësuari do të paguhet me shtesë mbi pagën bazë sipas kualifikimit por sipas pagës së paraparë në konkurs. Tutje ka shtuar se kjo kërkesë është vjetruar konform Ligjit të Punës nenit 87 dhe nenit 353 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, e gjithashtu lidhur me këtë rast nuk janë shterrur as mjetet admnistrative dhe juridike sipas procedurës administrative sepse paditësja nuk ka ndërmarr veprime për mbrojtjen e të drejtës së vet konform nenit 779 të Ligjit të punës, ku parashihet afati 30 ditor për ndërmarrjen e veprimeve në marrëdhëniet e punës. Lidhur me licencën

së mësimdhënësve shihet se validiteti i tyre ka skaduar. Lidhur me nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, ku paditësja kërkon pagë për shkak të licencimit të saj – pajisjes me leje pune mendojmë se ky nen është antiligjor dhe nuk ka bazë pasiqë licenca është kriter për themelimin e marrëdhënies së punës jo kriter për pagë shtesë. Lidhur me Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 në të cilën është mbështetur paditësi, ka theksuar se kontrata e tillë nuk është valide pasiqë me datë 22.01.2021 ka hyrë në fuqi Kontrata e Re Kolektive, ku sipas nenit 47 të kësaj kontrate me hyrjen në fuqi të saj shfuqizohet kontrata e datës 18.04.2018 dhe se pagesa e paditësit në lidhe me gradimin bëhet konform nenit 2 të Kontratës së Punës për mësimdhënës dhe sipas nenit 7 të K.K.A të Kosovës të datës 22.01.2021.

Në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur me datë 11.01.2023, përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse i propozuan gjykatës që për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës të kalohet drejtpërdrejtë në seancë kryesore, gjykata e pranoi propozimin e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, ashtu që konform nenit 420.3 të LPK-së, për shkak të ekonomizimit, efikasitetit të procedurës e gjithashtu për shkak të pandërlikueshmërisë së çështjes kaloi drejtpërdrejtë në shqyrtim kryesor të çështjes.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe për të vëretuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale dhe atë: Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 747 e datës 01.09.2015, Diploma e kualifikimit universitar në emër të N.B, Licenca me numër 100019950 e datës 20.05.2014 në emër të N.B, Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 752, Licenca e mësimdhënësit me numër 100019963 e datës 20.05.2014 në emër të N.H, Diploma e kualifikimit universtar ne emër të N.H, Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 750, Licenca e mësimdhënësit me numër 100019968 e datës 20.05.2014 në emër të S.P, Certifikata me numër 195/75 e datës 18.05.2012, Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 759, Licenca e mësimdhënësit me numër 100019965 e datës 20.05.2014 në emër të S.SH, Diploma e kualifikimit universitar në emër të Selami N.SH, Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 756, Licenca e mësimdhënësit me numër 100019973 e datës 20.05.2014 në emër të SH.SH dhe Diploma kualifikimit të lartë shkollor me numër 620 e datës 20.03.1994 në emër të SH.SH, kërkesa e datës 23.08.2021 në emër të N.B, N.H S.A S.SH dhe SH.SH, Lista e pagave me numër EM00016227 në emër të N.B, Lista e pagave me numër EM00016222 në emër të N.H, Lista e pagave me numër EM00116049 në emër të S.A, Lista e pagave me numër EM00016211 në emër të S.SH dhe Lista e pagave me numër EM00016231 në emër të SH.SH.

Nga Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 747 e datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja N.B ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar në SHFMU "Esat Berisha" në fshatin Llashticë, dhe e njejta që nga data 01.09.2015 në këtë shkollë punon si mësimdhënëse e mësimit klasor.

Nga Diploma e kualifikimit universitar në emër të N.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësja posedon diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Edukimit dhe ka marrë titullin Bachelor i Programit Fillor.

Nga Licenca me numër 100019950 e datës 20.05.2014 në emër të N.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është e pajisur me licencë të karrierës, e lëshuar me datë 20.05.2014.
Nga kërkesa e datës 23.08.2021 në emër të N.B, N.H S.A S.SH dhe SH.SH, vërtetua fakti se e paditësit iu kanë drejtuar të paditurës në procedurë administrative me kërkesë për kompensim.

Nga Lista e pagave me numër EM00016227 në emër të N.B, Lista e pagave me numër EM00016222 në emër të N.H, Lista e pagave me numër EM00116049 në emër të S.A, Lista e pagave me numër EM00016211 në emër të S.SH dhe Lista e pagave me numër EM00016231 në emër të SH.SH, gjykata vërtetoi faktin se pagën bazë e kanë 421 €.

Nga Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 752, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi N.H ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në SHFMU "Esat Berisha" në fshatin Llashticë, dhe i njejti që nga data 01.09.2015 në këtë shkollë punon si mësimdhënës i TIK-UT 10 orë dhe 10 orë MZ.

Nga Licenca e mësimdhënësit me numër 100019963 e datës 20.05.2014 në emër të N.H, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është e pajisur me licencë të karrierës, e lëshuar me datë 20.05.2014.

Nga Diploma e kualifikimit universtar ne emër të N.H, gjykata vërtetoi faktin se paditësi posedon diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Edukimit dhe ka marrë titullin Bachelor i Programit Teknologji – Informatikë.

Nga Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 750, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja S.P ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në SHFMU "Esat Berisha" në fshatin Llashticë, dhe e njejta që nga data 01.09.2015 në këtë shkollë punon si mësimdhënëse e mësimit klasor.

Nga Licenca e mësimdhënësit me numër 100019968 e datës 20.05.2014 në emër të S.P (...) gjykata vërtetoi faktin se paditësja është e pajisur me licencë të karrierës, e lëshuar me datë 20.05.2014.

Nga Certifikata me numër 195/75 e datës 18.05.2012, vërtetohet se paditësja S.P, ka marrë titullin Master i Pedagogjisë, në djretimin teorik – shkencor në Universitetin e Prishtinës, fakulteti Filozofik.

Nga Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 759, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi S.SH ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në SHFMU "Esat Berisha" në fshatin Llashticë, dhe i njejti që nga data 01.09.2015 në këtë shkollë punon si mësimdhënës i Edukatës Fizike.

Nga Licenca e mësimdhënësit me numër 100019965 e datës 20.05.2014 në emër të S.SH, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është e pajisur me licencë të karrierës, e lëshuar me datë 20.05.2014.

Nga Diploma e kualifikimit universitar në emër të Selami N.SH, gjykata vërtetoi faktin se paditësi posedon diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe ka marrë titullin Profesor i Kulturës Fizike.

Nga Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me numër 756, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi SH.SH ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në SHFMU "Esat Berisha" në fshatin Llashticë, dhe i njejti që nga data 01.09.2015 në këtë shkollë punon si mësimdhënës i Gjuhës Shqipe.

Nga Licenca e mësimdhënësit me numër 100019973 e datës 20.05.2014 në emër të SH.SH, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është e pajisur me licencë të karrierës, e lëshuar me datë 20.05.2014.

Nga Diploma kualifikimit të lartë shkollor me numër 620 e datës 20.03.1994 në emër të SH.SH, gjykata vërtetoi faktin se paditësi posedon diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", shkolla e lartë padagogjike dhe ka marrë titullin Arsimtarë i Gjuhës Shqipe.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësve dhe lartësisë së tyre, ka zbatur dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Sipas nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 është përcaktuar se "Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit, edhe atë: 1.1. Mësimdhënës me Shkollë Normale, 10 % e pagës bazë; 1.2. Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare, 19 % e pagës bazë; 1.3. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçare, magjistraturë/master dhe doktoraturë, 35 % e pagës bazë; 1.5. Përparimet në karriere, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10 %", ndërsa në nenin 35 për rregullat e përgjithshme dhe pagat janë përcaktuar rregullat për sistemin e pagave dhe shpërblimet, ashtu që në paragrafin 3 është përcaktuar se "Pagat e punëtorëve, punonjësve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHK-ut, nënshkruese e kësaj kontrate kolektive, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në qeveri për miratim", ndërsa në paragrafet në vijim është rregulluar paga e orës mësimore mbi normë, e shpenzimeve të rrugës (70 % e biletës së trafikut urban), e shtesës për përvojën e punës, e kompensimit për ushqim gjatë punës, e shpërblimit jubilar, e pagave përcjellëse dhe e shkallës së inflacionit.

Gjykata vlerëson se neni 35 i kontratës në fjalë ka karakter detyrues, ashtu që palët nënshkruese të kontratës obligohen në zbatimin e këtij neni, të cilat nga paragrafi 4 e deri në paragrafin 10 kanë rregulluar sistemin e pagave sa i përket orës mësimore mbi normë, shpenzimeve të rrugës, shtesës për përvojën e punës, kompensimit për ushqim gjatë punës, shpërblimit jubilar, pagave përcjellëse dhe shkallës së inflacionit, duke specifikuar saktësisht në këto paragrafe se mësimdhënësit i paguhen këto shpenzime/kompensime, e në këtë rast duke krijuar obligimin te pala nënshkruese, këtu e paditura. Në këtë drejtim, gjykata ka gjetur se në këtë nen nuk është përcaktuar pagesa e mësimdhënësve sa i përket licencimit-kualifikimit sipas diplomës universitare, andaj edhe rrjedhë obligimi i të padituës për pagesën e diferencës sipas licencimit.

Licencimi sipas nenit 7 të kësaj kontrate, gjykata vlerëson se nuk ka karakter detyrues për shpërblim të së njëjtës nga pala nënshkruese, këtu e paditura, pasi në këtë nen është përcaktuar mundësia e kualifikimit të mësimdhënësve, e cila rrjedhë sipas legjislacionit të punës dhe legjislacionit për arsim në fuqi, ndërsa nga Ligji i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë Parauniversitar e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë, gjykata nuk ka gjetur se është paraparë obligim për ngritjen e shkallës së pagës, sipas licencimit-kualifikimit, konkretisht neni 7 i KKAK-së nuk ka karakter imperativ dhe si i tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit, gjykata vlerëson se përcaktimi në aktet ligjore dhe nënligjore për ngritjen e shkallës së pagës është kusht që duhet plotësuar, në mënyrë që të merrë karakterin detyrues ky nen, siç e thekson edhe paragrafi 3 i nenit 35 të kontratës kolektive se pagat e punonjësve të arsimit përcaktohen me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndërsa ky kusht shihet se nuk është plotësuar, andaj i njëjti nen ka karakter deklarativ për palët nënshkruese, për më tepër këtë detyrim nuk e parasheh as UA, ku në nenin 17 janë përcaktuar punët dhe detyrat e secilit nga 9 faktorët e pjesëmarrjes në licencim, prandaj mbi bazën e të lartëcekurave gjykata vendosi si në pikën **I** të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në bazë të nenit 450 të LPK-së, meqë paditësja e kqa humbur kontestin, kurse e paditura nuk ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 142.1 lidhur me nenin 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 1554/21, datë 11.01.2023

Gjyqtarja,
Kaltrinë HALITI

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet nëkopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.